

AKTI I THEMELIMIT
TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR «KALIMERA»

S.I.P.K.

Ne Gjirokaster sot me daten 8.9.1999.ne:

- 1.Jorgo Papa i biri i Janit i DL.1973. banues ne Vanister, Gjirokaster.
- 2.Sokrat Kiki i biri i Thomait DL.1941. banues ne New York, SH.B.A. me pasaporte nr. 15725243
3. Ollga Papa e bija e Janit e DL.1972. banues ne Vanister, Gjirokaster dhe
- 4.Vasil Papa i biri i Janit i DL. 1979, banues ne Vanister, Gjirokaster,
vendosem qe te themelojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar sipas ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 «Per shoqerite tregetare» dhe ate me Nr. 7667 date 28.01.1993 «Per rregjistrin tregetar...» duke perpiluar kete akt themelimi me permabjtje si me poshte:

NENI 1

Te themelojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emertimin «KALIMERA» SH.P.K. te ortakeve Jorgo Papa, Sokrat Kiki, Ollga Papa dhe Vasil Papa.

NENI 2

Selia e shoqerise eshte ne fshatin Vanister, Gjirokaster.

Shoqeria mund te hapi filiale dhe agjenci edhe ne vende te tjera te Republikes se Shqiperise si dhe jashte saj me miratim te organeve kompetente.

NENI 3

Afati i veprimtarise se shoqerise do te jete 15 vjetë.Ky afat fillon me daten e regjistrimit te shoqerise ne rregjistrin tregetar prane Gjykates se rrethit Tirane. Shoqeria ne cdo kohe dhe per cdo shkak, me vendim te Asamblese se ortakeve mund te shperndahet ose te prishet.

NENI 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise dhe qellimi i saj do te jete:

Prodhim dhe tregetim i artikujve ushqimore, te brumit dhe embelsirave;tregeti e per gjitheshme import-export me shumice dhe pakice.

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete 100.000. leke. Ky kapital ndahet ne 10.000 pjese, vlera nominale e cdo pjese eshte 1000 lekë.'

Ky kapital eshte depozituar ne Degen e Bankes Gjirokaster si me poshte:

1. Jorgo Papa ka depozituar 32.000 leke ose 32 pjese ose 32 %.
2. Sokrat Kiki ka depozituar 28.000 leke ose 28 pjese ose 28 %
3. Ollga Papa ka depozituar 20.000 leke ose 20 pjese ose 20 %.
4. Vasil Papa ka depozituar 20.000 leke ose 20 pjese ose 20 %

NENI 6

Organi me i larte i shoqerise eshte Asambleja e ortakeve.

Kompetencat e saj percaktohen ne Statutin e shoqerise.

NENI 7

Administratoret i shoqerise caktohen Z. Jorgo Papa i biri i Janit, i Dl.1973, banues ne Vanister Gjirokaster dhe Vasil Papa i biri i Janit i Dl. 1979 banues ne Vanister, Gjirokaster. Keta perfaqesojne shoqerine para cdo organi dhe personi juridik ose fizik qofte privat ose shteteror Me gjeresisht kompetencat e tyre dhe menyra e ushtrimit te tyre percaktohen ne Statut.

NENI 8

Per arritjen e qellimit te saj shoqeria ka te drejte te punesoje punonjes dhe specialiste te tjere duke lidhur me ta kontrata te vecanta pune sipas K.Punes ne fuqi.

NENI 9

Veprimtaria ekonomike shoqerore e shoqerise do te mbyllte me 31 Dhjetor te cdo viti.


NENI 10

Shoqeria mbaron me vendim te Asamblese se ortakeve ose me ligj. Me mbarimin e saj shoqeria vihet ne likujdim.

NENI 11

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin midis ortakeve ne pamundesi te zgjidhjes se tyre me pajtim palet mund ti drejtohen organeve gjyqesore shqiptare sipas legjislacionit shqiptar.

ORTAKET	THEMELUES
JORG O	PAPA
SOKRAT	KIKI
OLI.GA	PAPA
VASIL	PAPA




REPUBLICA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE
GJIROKASTER

Nr. 4667 Rep.

V E R T E T I M

Ne Gjirokaster sot me datem 11/1999, para meje noteres Greta Kallojeri u paraqiten personalisht te quajturit Jorgo Papa biri i Janit i Dl. 1973,banues ne Vanister, Gjirokaster; Sokrat Kiki i biri i Thomait i Dl.1941,banues ne New York SH.B.A me pashaporte nr. 157252493; Ollga Papa e bija e Janit e Dl.972, banues ne Vanister, Gjirokaster dhe Vasil Papa i biri Janit i Dl. 1979 banues ne Vanister, Gjirokaster per te cilet u njofta sipas ligjit te cilet deklaruan se nenshkrimi ne kete Akt themelimi eshte i tyre.



STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR «KALIMERA» SH.P.K.

NENI 1

Themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin «KALIMERA» SH.P.K. me ortake themelues:

- 1.Jorgo Papa i biri i Janit i Dl , 1973 , banues ne Vanister , Gjirokaster .
- 2.Sokrat Kiki i biri i Thomait i Dl , 1941 , me pasaporte nr. 157252493 banues ne New York , SH.B.A.
- 3.Ollga Papa e bija e Janit e Dl , 1972 , banues ne Vanister , Gjirokaster.
- 4.Vasil Papa i biri i Janit i Dl , 1979 , banues ne Vanister , Gjirokaster,

NENI 2

Selia e shoqerise do te jete ne fshatin Vanister , Gjirokaster.

Shoqeria mund te hapi filjale dhe agjenci edhe ne teritorin tjeter te Republikes se Shqiperise si dhe jashte saj me miratimin e organeve kompetente.

NENI 3

Afati i veprimtarise se shoqerise eshte 15 vjet. Ky afat mund te zgjatet ose te shkurtohet me vendimin e Asamblese se shoqerise ne cdo kohe dhe per cdo shkak.

NENI 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise dhe qellimi i saj do te jete:

Prodhimi dhe tregetimi i artikujve ushqimore , te brumit dhe embelsirave tregeti e per gjithshme import – export me shumice e pakice.

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte **52.100.000** lekë:

Kapitali I mesiperm ndahet ne **100** pjese me nga **521.000** leke secila.

Kapitali themeltar eshte depozituar nga ortaket themelues ne raportet e me poshtme:

- 1.Jorgo Papa ka depozituar **16.672.000** lekë ose **32** pjese ose **32%**.
- 2.Sokrat Kiki ka depozituar **14.588.000** leke ose **28** pjese ose **28 %.**
- 3.Ollga Papa ka depozituar **10.420.000** leke ose **20** pjese ose **20%.**
- 4.Vasil Papa ka depozituar **10.420.000** leke ose **20** pjese ose **20%.**

Kapitali themeltar mund te shtohet me vendim te Asamblese te ortakeve sipas procedures qe kerkohet per ndryshimin e Statutit.

Cdo ndryshim i kapitalit themeltar pasqyrohet ne librin e shoqerise , ne te cilin shenohen emrat e ortakeve dhe kontributi i tyre.

NENI 6

Ortaku qe deshiron te shese pjesen e tij eshte i detyruar te njoftoje ortaket e tjere per ushtrimin e se drejtes se parablerjes. Ortaket jane te detyruar t'i pergjigjen ofertes se ortakut brenda 10 (dhjete) diteve nga data e marjes se komunikimit..Ne rast se shumica e ortakeve e blejne ate , atehere pjeset e blera i natjane proporcionalisht.

Ne rast mosmarreveshjeje persa i takon vleres se pjeseve qe afrohen per shitje , atehere caktohet nje expert kontabel per vleresimin e tyre.

Ne rast se eshte e pamundur te caktohet nje expert brenda 10 diteve , emerimi i tij behet nga Gjykata.

Ne rast se ortaket qe ftohen per mbledhje tregohen indiferent ose nuk pranojne te ushtrojne te drejten e parablerjes , ortaku shites ka te drejte te kerkoste persona te trete.Ne kete rast ndalohet shitja te me shume se nje person , me qellim qe te mos prishet ekuilibri i krijimit te shumices ne Asamblene e ortakeve.

Kalimi ose transferimi i pjeseve kryhet gjithmone me akt notarial.

Ne rast vdekjeje te ndonjerit prej ortakeve , trashegimtaret e tij ligjore , trashegojne te drejtat dhe pjesen e tij.

NENI 7

Shoqeria mban librin e ortakeve me te gjitha te dhenat si emri , mbiemri , shtetesi , adresa e banimit ose e selise , pjeset e secilit ortak , kontributet ne kapitalin themeltar dhe ndryshimet e mundshme.

Konsiderohen ortak dhe mund te ushtrojne te drejtat e tyre para organeve te shoqerise te gjithe ata persona qe jane regjistruar ne librin e shoqerise.

NENI 8

Organet e shoqerise jane Asambleja e Pergjithshme dhe Administratori.

Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte i shoqerise dhe vendos per cdo ceshtje qe ka lidhje per shoqerine .Ajo vendos per ndryshimin e Statutit , per emerimin dhe shkarkimin e Administratorit , per pranimin e ortakeve te rinj , per shtimin e kapitalit themeltar , per miratimin e bilancit vjetor , per ndarjen e fitimeve per kerkese padi kundrejt perfaquesuesve te shoqerise pa asnje kyfizim , brenda kushteve te percaktuara ne Statut dhe ligji.

Asambleja e Zakonshme mblidhet te pakten nje here ne vit dhe bile gjate tremujorit te pare nga data e perfundimit te vitit ekonomik.Thirrja per kete mbledhje behet me shkrim te pakten 15 (pesembedhjete) dite perpara.

Asambleja e Jashtezakonshme thirret nga Administratori ose nga ortaket qe perfaqesojne 10 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme eshte e vlefshme ne rast se marrin pjesa ortaket qe perfaqesojne me teper se gjysmen e kapitalit themeltar.Vendimet e Asamblese miren me shumice votash te kapitalit qe marrin pjesa ne mbledhje.Nje pjesa e kapitalit i takon e drejta e nje vote.

Per ndryshimin e Statutit kerkohet miratimi i ortakeve qe perfaqesojne ¾ pjesa te kapitalit themeltar.

Ne cdo mbledhje te Asamblese se Pergjithshme mbahet proces verbal i cili firmoset nga ortaket qe marrin pjese ne mbledhje.

NENI 9

Shoqeria drejtohet gjate aktivitetit te saj nga Administratoret.

Administratoret e shoquerise caktohen Z.Jorgo Papa i biri i Janit I Dl.1973 , banues ne Vanister , Gjirokaster dhe Z.Vasil Papa i biri i Janit I Dl.1979 banues ne Vanister , Gjirokaster.

Ata drejtojne dhe administrojne ceshtjet e perditshme te shoquerise ne baze te ligjit , Statutit vendimeve dhe udhezimeve te Asamblese se Pergjithsme , perfaqeson personin juridik dhe vepron ne emer e per llogari te tij per arrijen e qellimit te shoquerise.Ne per gjithesi kujdeset per te gjitha punet ne shoqeri.Ata perfaqesojne shoqerine para organeve shteterore dhe private , personave fizike e juridike duke firmosur poshte emertimit te shoquerise.Administratoret mund t'i shkarkoje Asamblja e Pergjithshme .Administratoet perfaqesojne shoqerine para gjithe organeve gjyqesore, komisioni shteteror apo organi , para cdo personi fizik apo juridik , terheqin nga bankat apo institucionet e tjera kredidhenese , caktojne avokat te tjere autorizues , marrin ne pune personelin per shoqerine dhe caktojne rrogat dhe marredheniet e punes.Administratoret mund te ushtrojne kompetencat e tyre se bashku ose dhe vec e vec ose nepermjet perfaqesuesit qe caktojne vete si per nje , per disa ose per te gjitha kompetencat e tyre si Administratore me miratim te Asamblese se ortakeve.

NENI 10

Ne fund te cdo viti finanziar dhe nen kujdesin dhe perjegjesine e Administratoreve , kryhet perpilimi i te gjitha te dhenave te aktivit dhe pasivit me pershkrim te hollesishem.Ne baze te ketij pershkrimi nga Administratoret perpilohet bilanci me anajize te hollesishem te llogarise humbje-fitim.

Viti finanziar fillon me 1 Janar te cdo viti kalendarik dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Ky vit finanziar fillon pas regjistrimit te shoquerise ne zyre e Tatimeve dhe fillimit te aktivitetit.

Brenda tremujorit te pare pas perfundimit te vitit finanziar perpilohet bilanci i cili duhet te miratohet nga Asambleja e Pergjithshme e Zakonshme e shoquerise.

Fitimet e realizuara ndahen midis ortakeve ne raport me kontributin e tyre ne kapitalin e shoquerise.

NENI 11

Shoqeria prishet ose me vendim te Asamblese se Pergjithshme ose ne baze te ligjit.Ne rast prishjeje te shoquerise do te ndiqet procedura e likujdimit te saj ne baze te dispozitave ligjore.Likujduesit caktohen nga Asambleja e

Pergjithshme.Kur shoqeria prishet me vendim te Asamblese sePergjithshme vendimi eshte i vlefshem kur miratohet nga shumica e kerkuar per ndryshimin e statutit.


Gjate periudes qe shoqeria eshte ne likujdim ne emertimin e shoqerise shtohen fjalet «Ne likujdim».

NENI 12

Ne rast mosmarreveshjeje kur keto nuk zgjidhen me mirekuptim , do te zgjidhen ne rruge gjyqesore nga gjykata shqiptare sipas legjisacionit shqiptar.

ORTAKET THEMELUES

JORGO PAPA



SOKRAT KIKI



OLLGA PAPA



VASIL PAPA



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE
GJIROKASTER**

Nr. 1893 Rep.

VERTE TIM

Ne Gjirokaster sot ne daten 04.10.02, para meje noteres Greta Kallojeri u paraqiten personalisht te quajturit Jorgo Papa i biri i Janit i Dt.1973, banues ne Vanister Gjirokater, Sokrat Kiki i biri i Thomait i Dt. 1941 banues ne New York, SH.B.A, Ollga Papa e bija e Janit i Dt.1972, banuese ne Vanister Gjirokater, dhe Vasil Papa i biri i Janit i Dt.1979, banues ne Vanister Gjirokater per te cilet u njojta sipas ligjit te cilet deklaruan se perpilimi i ketij statuti dhe nenshkrimi ne te eshte i tyre dhe shprehje e lire e vullnetit te tyre dhe une noterja pasi u binda per kete bez legalizimin sipas ligjit.



DHOMA E NOTEREVE
GJIROKASTER
NOT. GRETA KALLOJERI
TEL: 2278

